



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt. 04.09.2023

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 42.1, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe Vendimit të dt. 21.12.2022, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: : 632-21-6570-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 632-21-121-521. dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-31803, për shkak të pamundësisë- mos lejitimit të ndërtimit të pendës në lumin Drin nga MMPHI-ja, për arsye se lumenjtë janë nën Administrimin e Ministrisë përkatëse. në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiave ligjore më dt. 04.09.2023, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

1. Për shkak të pamundësisë- mos lejitimit të ndërtimit të pendës në lumin Drin nga MMPHI-ja,, Kontrata me numër të prokurimit: 632-21-6570-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 632-21-121-521 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-31803, e dt. 20.10.2021, me titull "Ndërtimi i pendës të ura e Fshejtë në lumin Drin-Kontratë dy vjeçare", në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve Lulzim Beqiraj B.I.; FIDANI-BETON SH.P.K., me seli Rr. Arben Qerimaj , Nr 180, Deçan, NDËRPRITET ME MARRËVESHJE MES DY PALËVE KONTRAKTUESE.
2. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës për shkak të mos lejitimit të ndërtimit të pendës në lumin Drin nga MMPHI-ja, për arsye se lumenjtë janë nën Administrimin e Ministrisë përkatëse, në pajtim me nenin 42.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK dhe rekomandimit të Menaxherit të kontratës kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.
3. Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin për Ndërtimi i pendës te ura e Fshejtë në lumin Drin-Kontratë dy vjeçare”, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve Lulzim Beqiraj B.I.; FIDANI-BETON SH.P.K., me seli Rr. Arben Qerimaj, Nr 180, Deçan, për kryerjen e punëve të kontraktuara sipas Kontratës.

Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit në kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratës, Zyrtari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues – Kryetari i Komunës, me Vendimin e tij 112/02-37882 të dt. 16.12.2021, ka emëruar Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejte te Menaxherit te Kontratës, me të drejta dhe obligimet sikurse janë përcaktuar në Vendim.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës dërguar në rrugë elektronike ne Zyrën e Prokurimit me date 16.08.2023, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës .


Me date 01.09.2023, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ka dorëzuar “Njoftimin për shkëputje me marrëveshje te kontratës” te kryesi i punëve Lulzim Beqiraj B.I.; FIDANI-BETON SH.P.K., me seli Rr. Arben Qerimaj, Nr 180, Deçan.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave te Prokurim Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.

Ardian Gjini



Kryetari i Komunës

Faton Gutaj



Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

- Operatorit Ekonomik;
- Zyrës së Kryetarit te Komunës;
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Drejtorisë për Shërbime Publike
- Drejtorisë për Buxhet dhe financa
- Menaxherit të kontratës;
- Arkivës së Komunës.